



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12.060.23025 dt. 30.06 2020

Mbledhja urgjente e
Kuvendi Komunal
27.03.2020,

PROCESVERBAL

I mbledhjes urgjente të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 27.03.2020, përmes emailit me votimit onëljajn.

Mbledhjen e kryesoi përmes emailit onlajn: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes urgjente të Kuvendit Komunal, përmes votimit elektronik ku ju dërgoi vendimin për votim 30 anëtarëve të asamblesë Komunale ku dhe vetë i pranishëm gjithsejtë 31, në komunikim përmes emailit në onlajn.

Kryesuesi i Kuvendit filloi punimet përmes emailit në onlajn më këtë :

Rend dite:

1. Ndryshim i Propozim Vendim për bartjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19, me rekomandim të MAPL-së.

Prezent gjatë mbledhjes urgjente me votim onëljajn të datës 27 /03/ 2020, ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse dhe këshilltarët e asamblesë Komunale përmes emailit në onlajn.

Mbledhjen me votim online për mes e-mailit e hapi Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, duke ju drejtuar 30 anëtarëve të Kuvendit Komunal me shkrim përmes emaili elektronik.

Të nderuar Asambleist,

Duke pasur parasysh shkresën e Ministrisë së Financave, të datës 26.03.2020, me anë të së cilës kërkohet që mjetet të merren 5% të investimeve kapitale nga nënprogramet, duke mos lejuar që komplet mjetet të merren nga i njëjti projekt, me mirëkuptim kërkoj nga ana juaj që të votoni përmes e-mailit për ndryshimin e këtij propozim vendimi, sot me datë 27.03.2020, nga ora 14:00-15:00.

Përgjigja nga ana juaj në e-mail tim, duhet të ketë këtë përmbajtje:

Lidhur me Propozim Vendimin Nr.01-400/01/14183, të datës 27.03.2020, në mënyrë elektronike përmes e-mailit tim, unë N.N votoj: _____ (Për, Kundër apo Abstenoj).

Bashkangjitur gjeni ftesën për seancë, propozim vendimin e ndryshuar si dhe shkresën e Ministrisë së Financave.

Teksti sipas shkresës së MAPL-së të datës 26.03.2020, ora 16:03:11, sipas rekomandimeve i hedhur me copy paste nga shkresa në pdf:

Sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, Nr.12.400/01- 14098, datë 25.03.2020, të komunës së Drenasit, kërkohet lejimi i transferit të mjeteve financiare në vlerë 229,200 Euro për menaxhimin e situatës së krijuar nga virus COVID-19, nga kategoria Shpenzimet kapitale, nga programi Administratë dhe personeli (16301), në programin Shëndetësi dhe mirëqena sociale (73010), ku përqindja e ndarjes së ndikuar negativisht të këtij programi është 95.82%.

Sqarojmë se çështja e transfereve buxhetore është e rregulluar sipas Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, si dhe Ligjit nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2020, neni 15, paragrafi

Gjithashtu, sipas Udhëzimit administrativ MF-nr.05/2019, neni 6, paragrafi 1.3 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore, nuk lejohet që OB të bëjnë transfere gjatë tremujorit të parë të vitit fiskal.

Sipas Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30.2 Ministri, ka të drejtë aprovimin e kërkesës së transferit deri në 15% të ndarjes së ndikuar negativisht, neni 30.3, mbi 15% deri 25 %, miratimi me shkrim nga Qeveria dhe neni 30.4, mbi 25% apo më tepër kërkohet miratimi me shkrim nga Kuvendi.

Po ashtu në Vendim nuk është e cekur se nga kategoria e shpenzimeve kapitale në cilën kategori të shpenzimeve këto mjete duhet transferohen.

Me respekt,

Jeton Gashi

Udhëheqës i Divizionit të Buxhetit Komunal

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; Votimi u ka përfunduar në ora 17:00, ku të gjithë asamblistit përmes votimit elektronik online votuan në mënyrë unanime.


Ky propozim Vendim u përkrah nga 19, asamblist me votim elektronik.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal pasi përfunduan votimet onëljajnë konsideroi të mbyllur seancën.

Procesverbalit i bashkëngjiten të gjithë emailat e votimit të printuara nga anëtarë e Kuvendit përmes email adresës, si dhe shkresa e MAPL-së me rekomandime përmes emailit.

Drenas 27.03.2020

Procesmbajtëse:



Zahrie Podrimqaku Subashi



Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj
Labinot Halilaj